




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Grupi punues për hartimin e Draft Statutit të Komunës, duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr. 03/2014 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 65 Statutit të Komunës së Gjakovës, me datë 31.10.2022 publikon këtë:

NJOFTIM

Grupi punues për hartimin e Draft Statutit të Komunës së Gjakovës, organizon konsultim publik me qytetarët e Komunës së Gjakovës dhe personat tjerë të interesuar lidhur me Draft Statutin e Komunës së Gjakovës.

Qytetarë të nderuar të Komunës së Gjakovës është në interesin tuaj që të merrni pjesë në këtë konsultim publik dhe të kontribuoni që ky draft Statut të jetë sa më praktik dhe profesional.

Kopja fizike e Draft Statutit të Komunës së Gjakovës mund të sigurohet në zyrën informative, gjegjësisht në objektin e Komunës së Gjakovës çdo ditë punë prej orës 10:00 deri në orën 14:00, duke filluar nga data 01.11.2022, si dhe në ueb faqen zyrtare të komunës së Gjakovës.

Konsultimi publik mbahet me datë 01.12.2022 në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjakovës (ish ndërtesa e Bankos-it), me fillim nga ora 10:00.

Vërejtjet apo komentet tuaja lidhur me këtë draft Statut mund ti drejtohen grupit punues drejtpërdrejtë në konsultim publik, apo me shkrim përmes e-mailit nita.efendia@rks-gov.net.

Nita Efendia Brovina

Kryesuese e grupit punues

